

PROJEKTVENDIM

NR. ___, DATË __/__/2025

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURËS SË SHPËRNDARJES SË SUBVENCIONIMIT PËR
OPERATORËT E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK QYTETAS NË
BASHKINË Durrës

Në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 3743, datë 10.7.2017, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve, të ndryshuar, VKB-së nr. 590, datë 11.03.2019, “Për miratimin e ndryshimit të VKB- nr.233, datë 16.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e procedurës së shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në Bashkinë Durrës.
2. Miratimin e kompensimit nga ana e Bashkisë Durrës të vlerës 10 lekë nga vlera totale e çmimit të biletës 40 lekë.

3. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027.

4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike si dhe operatorët e transportit publik qytetës në Bashkinë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör


Alneida Rroshi



DREJTORIA E SHËRBIMEVE

Drejtör

Ardian Hiazaj



DREJTORIA EKONOMIKE

Drejtör

Ermal Lufo



KRYETAR

Emiriana Sako

